

10.05.2024

Ora, 11:53

RENDI I DITËS

“Për pranimin për shqyrtim të kërkesës ankimore nr. 05, datë 8.05.2024 të depozituar nga subjekti “Partia Socialiste e Shqipërisë”.

PJESËMARRJA :

- **KAS:** Z. Elvin Lako, z. Elvis Çefa,
z. Koli Bele, z. Ledio Braho.
- **Stafi KQZ:** Znj. M. Koja, znj. J. Josifi, z. E. Mema.
- **Parti Politike:** PSSH (znj. Sh. Ballhysa)
- **Të tjerë:** S’ka

Z. E. Çefa: Mirëdita të gjithëve! Atëherë, deklarojmë të hapur seancën e shqyrtimit paraprak, të kërkesës ankimore nr. 5, të datës 8.05.2024, paraqitur nga subjekti politik Partia Socialiste e Shqipërisë, me objekt “Kundërshtimin e vendimit të KSHZ “Për miratimin e raportit mbi gjetjet nga auditimi i raporteve financiare të partive politike për të ardhurat dhe shpenzimet për vitin kalendarik 2022””. Partia Socialiste ankimon pikën 5 të këtij vendimi, në bazë të së cilës, ky subjekt politik është gjobitur në vlerën gjashtëdhjetëmijë lekë, për shkeljet e konstatuara në raportin e miratuar nga Komisioneri. Fillimisht verifikojmë prezencën! Është prezent trupa e KAS-it në shumicë të saj, për arsye të justifikuara kolegu Rusmali nuk do të jetë prezent. Është prezent administrata e KQZ-së, këtë rradhë, për arsye objektive Komisioneri do të përfaqësohet në këtë procedim administrativ nga,

*Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike
të Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt. 10.05.2024*

Znj. M. Koja: Madalena Koja, drejtoreshë e Drejtorisë Ligjore, me autorizim nga Komisioneri.

Z. E. Çefa: Ju faleminderit! Subjekti ankimues Partia Socialiste, ka paraqitur gjithashtu një autorizim, ku autorizohet zonjusha që të ndjekë procesin e shqyrtimit të kërkesës ankimore, ju lutem prezantohuni!

Znj. Sh. Ballhysa, përfaqësuese e PSSH: Shila Ballhysa!


Z. E. Çefa: Atëherë dakord! Ndonjë pretendim apo kërkesë paraprake në lidhje me përbërjen e trupës, nga ana e ankimuesit? Nuk kemi! Nga trupa, ndonjë deklaratë paraprake? Nuk kemi! Atëherë, shkurtimisht vijojmë me shqyrtimin e elementëve të formës dhe të përmbajtjes së kërkesës ankimore të subjektit Partia Socialiste e Shqipërisë, e cila është sanksionuar për këto arsye:

- Partia nuk ka llogaritur dhe amortizuar për ndërtesën që ka në huapërdorje sipas VKM nr. 196, të vitit 1992. Vlera e ndërtesës me huapërdorje nuk është e rivlerësuar sipas kërkesave ligjore dhe paraqitet në vlerën e vitit 1993. Pra, llogaritja e amortizimit duhet të bëhet sipas kërkesave të nenit 22, pika “b” të ligjit nr. 8438/1998, të ndryshuar. Po ashtu,

- Partia Socialiste e Shqipërisë, nuk ka paraqitur të ndarë aktivitetin e saj vjetor të zakonshëm dhe aktivitetin për fushatën zgjedhore. Po ashtu,

- Pagesat e kryera nga ky subjekt politik për shpërblimin e fundvitit si dhe pagesat për punë shtesa nga disa punonjës të saj, nuk janë përfshirë në listpagesat e raportuara nga organet fiskale. Për të gjitha këto pagesa është llogaritur dhe raportuar gabim trajtimi në burim, me tarifë 15%, kur ndërkohë duhet të ishin raportuar si të ardhura personale duke u llogaritur dhe tatimi mbi pagën për secilin punonjës.

*Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike
të Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt. 10.05.2024*

Shkelja e fundit për të cilën ky subjekt është sanksionuar është se,


- Nuk janë kaluar nëpërmjet llogarive bankare pagesat ndaj disa punonjësve të jashtëm që kanë punuar për llogari të partisë, si dhe pagesat e shpërblimit të fundvitit.

Me këtë vendim, subjekti politik ka marrë dënim në datën 23.04.2024, kështu që në këtë këndvështrim ankimi është paraqitur brenda afatit, po ashtu subjekti politik legjitimohet në kërkim dhe KAS-i është trupa kompetente për shqyrtimin e këtij ankimi. Për elementët e formës dhe të përmbajtjes, fillimisht do t'i japim fjalën përfaqësueses së Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve dhe më pas përfaqësueses së subjektit.

Znj. M. Koja: I nderuar zoti Relator! Të nderuar anëtarë të Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve! Në lidhje me çështjen që kemi sot në shqyrtim, më lejoni t'ju informoj se Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve, në seancë administrative, ka marrë në shqyrtim raportet e gjetjeve të auditëve të fondeve të përfituara dhe të shpenzuara nga partitë politike për vitin 2022 dhe në përfundim të procedurës, ka disponuar me vendimin nr. 38, datë 9.04.2024 ku ka vendosur masë administrative për disa subjekte zgjedhore. Ndër ta dhe për subjektin ankues Partia Socialiste e Shqipërisë, e cila ka depozituar kërkesën ankimore nr. 5, në datën 8.05.2024, siç ju referuat brenda afatit ligjor. Nëpërmjet kërkesës ankimore ata kundërshtojnë vendimin e Komisionerit. Nga verifikimi paraprak i kryer nga administrata, konstatohet se kërkesa është brenda afatit dhe plotëson elementët formalë të parashikuara në nenet 126 dhe 130 të Kodit Zgjedhor. Për këto arsye, ne i kërkojmë KAS-it kalimin e kërkesës për shqyrtim, faleminderit!

Z. E. Çefa: Ju faleminderit! Përfaqësuesja e subjektit nuk ka se çfarë shton, atëherë kolegë, ndonjë pyetje? Po zoti Lako!

*Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike
të Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt. 10.05.2024*

Z. E. Lako: Në fakt jo pyetje, por më shumë një konstatim. Ky vendimi... nuk i shoh as numër, as datë këtij vendimi të Komisionerit?

Z. K. Bele: Është i referuar këtu poshtë... E kam hasur dhe në një rast në një çështje që kishim më parë. Po shoh se në vendim kemi bazën ligjore dhe sanksionin, në qoftë se unë nuk e kam gabim. Por nuk shoh asnjë paragraf arsyetues në kuptimin formal.

Znj. M. Koja: Duke qenë se është miratuar raporti i gjetjeve, të gjitha konstatimet janë në dokumentin bashkëlidhur raportit të gjetjeve.

Z. K. Bele: Pra, dua të kuptoj se kështu ka qenë dhe në rastin e mëparshëm. Pra, ju konsideroni se raporti bashkëlidhur e ezauron, se në kujtesën time, akti administrativ kërkon një pjesë arsyetuese si çdo akt tjetër. Pra kërkon, ka ato ekstremitetet, kush e ka lëshuar, datën, ekstremitetet e hyrjes dhe të përfundimit të aktit, se ndoshta gjuha nuk është e duhura, por një akt administrativ duhet të ketë një pjesë arsyetuese, mund të jetë e përmbledhur, që të arrish te sanksioni. Siç e kuptoj unë, se ky akt është vendimi, te raporti janë gjetjet. Ndoshta...

Z. E. Çefa: Në fakt lidhja e gjetjeve me sanksionin duhet arsyetuar, absolutisht!

Z. K. Bele: Ndoshta për ekonomi nuk është e thënë që për çdo nga këto masat., po një arsyetim i shkurtër, ose të paktën., mund ta kem unë gabim., e kisha dhe në formën e pyetjes nuk e di se çfarë mendojnë dhe kolegët, por edhe ju në qoftë se keni ndonjë koment për të bërë.

*Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike
të Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt. 10.05.2024*

Z. E. Çefa: Po zonja Koja!

Znj. M. Koja: Në pikën 1 të vendimit të Komisionerit, miratohet pikërisht raporti i gjetjeve. Vendimi nr. 38 ka miratimin e raportit të gjetjeve dhe bazuar në gjetjet dhe konstatimet. Më pas propozohen apo vendosen masat administrative të sanksioneve siç vijohet nga pika 2 e deri në fund më pas. Pra, raporti i gjetjeve janë...

Z. K. Bele: Pra, pika 1 është arsyetimi i këtij vendimi!

Znj. M. Koja: Pikërisht! Pikërisht!

Z. E. Çefa: Dakord! Atëherë, KAS i konsultuar në vend, vendosi:

Kalimin për shqyrtim të kërkesës ankimore me nr. 5. Për efekt respektimi të afatit të ankimeve edhe nga subjektet e tjera që janë sanksionuar me të njejtin vendim të Komisionerit, pra për të pritur dhe afatin 30-ditor, për ankime të mundshme, seanca e shqyrtimit të kësaj kërkesë do të zhvillohet në datën 4.06.2024, ora 11:00. Në pritje sikundër e thashë dhe të ndonjë ankimi tjetër të mundshëm. Me kaq, këtë seancë e deklaroj të mbyllur, faleminderit të gjithëve!

Vendimi nr. 9

*Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU*